

## Shpjegim i "Libri i teuhidit" – 7

(E drejta e Allahut ndaj njerëzve)

Mësime të mbajtura nga dijetari i njohur Salih Ibn Abdul Aziz Muhamed Ali Shejh

(Allahu e faltë atë, prindërit e tij dhe të gjithë muslimanët!)

Përkthyes: Bilbil Talla

Redaktor: Ilir Haxhiaj

### Kapitulli: Komenti i teuhidit dhe i dëshmisë "La ilahe il-Allah"

Është qartësuar më parë se teuhidit është dëshmia "La ilahe il-Allah". Dijetarët kanë thënë se lidhëza "dhe" në emërtimin e këtij kapitulli lidh fjalë sinonimike me njëra-tjetrën. Por për këtë ka një lloj dyshimi, pasi këtu nuk kemi të bëjmë me sinonime, domethënë sinonime të plota, por me sinonime të pjeshme. Kështu, lidhëza "dhe" bashkon dy sinonime pak të ndryshme nga njëra-tjetra.

**"Shpjegimi i teuhidit"** domethënë: zbardhja dhe qartësimi i domethënies së teuhidit. Kemi thënë më lart se *teuhid* do të thotë të besosh se Allahu i Lartësuar është Një, pa shok në *rububije*, në adhurim, në emrat dhe cilësitë e Tij. Askush nuk është i ngjashëm me Atë. Allahu i Lartësuar thotë: **"Asgjë nuk i shëmbëllen Atij. Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha."**<sup>1</sup> Kjo i përfshin të gjitha llojet e teuhidit. Atëherë teuhidi është besimi se Allahu është Një në të tri llojet e teuhidit.

**"... dëshmia La ilahe il-Allah"** domethënë shpjegimi i dëshmisë "La ilahe il-Allah". Kjo dëshmi është fjala më e madhe që thotë një *mukelef* (musliman i ngarkuar me detyra). Nuk ka fjalë më të madhe sesa kjo, sepse për shkak të këtij kuptimi qëndrojnë Toka dhe qiejt. Të gjitha krijesat janë bërë vetëm për qëllimin e përmbushjes dhe zbatimit të kësaj dëshmie.

Dëshmia herë ka të bëjë me diçka që ke parë dhe ke dëshmuar dhe herë me pasjen dituri rreth diçkaje. Domethënë, dikush mund të dëshmojë për diçka që ka parë ose për diçka rreth së cilës ka njohuri. Këto janë dy kuptimet e dëshmisë. Nëse një person thotë "Unë dëshmoj", dëshmia e tij mund të jetë për diçka që ka parë dhe ka qenë i pranishëm afër saj, ose edhe për diçka rreth së cilës ka njohuri. Kuptimi i dëshmisë "Eshhedu en La ilahe il-Allah" është dëshmia rreth diçkaje që ne kemi njohuri, prandaj dhe thënia "Eshhedu" (dëshmoj) lidhet me diturinë.

Shehadeti në aspektin gjuhësor, në Sheriat dhe në komentimin që të parët tanë i kanë bërë ajeteve kuranore, të cilat përmbajnë fjalën "*shehide*" (dëshmoi), si në

---

<sup>1</sup> ESH-SHURA: 11.

thënien e Allahut: “Allahu dëshmon e po ashtu engjëjt dhe njerëzit e dijes se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij, duke mbajtur drejtësinë. S’ka zot tjetër përveç Atij, të Plotfuqishmit, të Urtit.”<sup>2</sup> dhe “Përveç atyre që dëshmuuan për të Vërtetën dhe e dinë mirë (se s’ka Zot tjetër të vërtetë veç Allahut)”<sup>3</sup>, përmbledh disa çështje:

E para: Besimi në atë që shqipton dhe besimi në atë që dëshmon, se të dëshmosh “La ilahe il-Allah” do të thotë ta besosh me zemër, me dije dhe me siguri kuptimin e kësaj dëshmie. Besimi nuk është i vërtetë në rast se nuk është me dije dhe siguri të patundur.

E dyta: Shqiptimi i saj. Dëshmia kërkon që ta besosh atë që dëshmon, ashtu siç kërkon edhe ta shqiptosh.

E treta: Deklarimi i saj me gjuhë.

Kështu, kuptimi i dëshmisë “*Eshhedu en la ilahe il-Allah*” është: Besoj, shqiptoj, di dhe tregoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut. Kjo e dallon dëshminë nga besimi në vete, shqiptimi në vete dhe deklarimi i zhveshur nga besimi. Andaj, që të përmbushet dëshmia duhet të bëhen bashkë të tre këta elementë (besim, shqiptim dhe lajmërim). Edhe në përkufizimin e imanit ne themi se është besim me zemër, shqiptim me gjuhë dhe veprime konkrete.

Shprehja: “La ilahe il-Allah” (deviza monoteiste) përmban katër fjalë:

- 1- “*la*”: nuk
- 2- “*ilahe*”: i adhuruar
- 3- “*il-la*”: përveç
- 4- Emri i të Lartësuarit: *Allah*.

Fjala “*la*” (nuk) është mohuese e llojit. Këtu ajo mohon hyjnizimin e gjithkujt tjetër përveç Allahut të Lartësuar. Nëse vjen pas mohimit “*il-la*” (përveç), e cila është pjesëz përjashtuese, ka kuptim të shtuar, që është kufizimi ose limitimi, gjë që nënkupton se adhurimi i drejtë dhe i vërtetë i takon vetëm Allahut dhe askujt tjetër.

---

<sup>2</sup> AL-IMRAN: 18.

<sup>3</sup> EZ-ZUHRUF: 86

Fjala "*ilah*" (zot, i adhuruar) është në formën foljore "*fial*", e cila vjen me kuptimin e "*fail*" (kryefjalë). Gjithashtu vjen edhe si "*mef'ûl*" (kundrinor). Burimi i kësaj fjale është nga "*elehe*", "*abede*" që domethënë: adhuroi.

Disa gjuhëtarë kanë thënë se burimi i fjalës është "*elehe*"-"*je'lehu*" me kuptimin "*tehajjera*"<sup>4</sup> domethënë: u habit dhe u turbullua. Për ta, Zoti u quajt në këtë mënyrë, për shkak se mendjet janë të paqarta dhe të paditura rreth realitetit dhe përshkrimit të Tij. Por ky mendim nuk është i saktë. Mendimi i saktë është se fjala "*ilah*" është në njësinë e foljeve (*fial*), e cila vjen me kuptimin "*mef'ûl*" (e kundrinorit) - i Adhuruari. Këtë e tregon edhe leximi që Ibn Abassi i bën ajetit në suren el-A'raf: "A mos, vallë, do ta lësh Musain dhe popullin e tij që të bëjnë ngatërresa në tokë dhe që të braktisin ty dhe zotat e tu?"<sup>5</sup> Ibn Abasi fjalët "...që të braktisin ty dhe zotat e tu?" i lexonte: "...që të braktisin ty dhe adhurimin tënd?"<sup>6</sup> Domethënë se Ibn Abasi nga fjalët "...që të braktisin ty dhe zotat e tu?" kuptoi "...që të braktisin ty dhe adhurimin tënd?", pasi Faraoni nuk adhuronte dikë, por ai adhurohej nga të tjerët.

Fjala "*la*" (Nuk) në thënien "*La meabud*" (nuk ka të adhuruar me të drejtë) është mohuese e llojit dhe ka nevojë për emër dhe kallëzuesor, sepse "*La*" vepron si "*inne*" (pjesëz përforcuese). Nëse pyet ndonjë se ku është kallëzuesori i "*la*" (nuk) mohuese të llojit, themi se shumica e dijetarëve mendojnë se kallëzuesori fshihet në fjalinë "nuk ka zot ekzistues, përveç Allahut".

Për të shpjeguar fillin e këtij mendimi, është nevoja e një paranteze: Mutekeliminët (skolastikët muslimanë), esharitë dhe mutezilët, si dhe ata që trashëguan njohuritë greke thonë se fjala "*ilah*" është në trajtën e "*feal*" në kuptimin e kundrinorit ose të kryefjalës. Ata thonë se kjo fjalë ka kuptimin "*Alih*", që do të thotë: i aftë, i fuqishëm. Kështu, me fjalën "*ilah*", ata kuptojnë atë që është i aftë për të sjellë diçka nga inekzistenca. Këtë e gjejmë të shkruar në besimin e esh'arive, si për shembull në librin "*Senusije*", të cilën ata e quajnë "*Umm el berahijn*" (nëna ose burimi i argumenteve), ku thuhet tekstualisht: "*El-ilah*" është ai, që nuk nevojë për të tjerët ndërsa të tjerët që të gjithë kanë nevojë për të." Pastaj thonë se kuptimi "La ilahe il-Allah" është: Askush nuk është i vetëmjaftueshëm dhe askush nuk ia ka nevojën kurrkujt, përveç Allahut<sup>7</sup>. Në këtë mënyrë, teuhidin *uluhije* ata e shpjegojnë me teuhidin *rububije* dhe realitetin e Allahut e shpjegojnë si: i Afti për t'i krijuar gjërat nga asgjëja apo Ai që nuk ia ka nevojën askujt, ndërsa gjithkush ia ka nevojën Atij. Për këtë arsye, ata mendojnë

<sup>4</sup> Shiko: *Muaxhem Mekajisul Lugah*: 1:127 dhe *Tefsiri Keshaf*: 1:49.

<sup>5</sup> EL-EL-ARAF': 127.

<sup>6</sup> Ky lexim bën pjesë në shtatë llojet e leximit.

<sup>7</sup> Shiko: "Ummul berahijn" e përfshirë tek: "Mexhmua muhimat el-menu", faqja: 7 – 8.

se kallëzuesori qëndron tek fjala "ekzistencë", pra për ata kallëzuesori i thënies "La ilahe" është "*meuxhûdun*" (ekzistencë). Për rrjedhojë, thënia "La ilahe il-Allah" për ata do të thotë: "Nuk ka fuqi shpikëse dhe krijuese në ekzistencë, përveç Allahut; askush nuk është i vetëmjaftueshëm, përveç Tij; askush nuk ia ka nevojën askujt në ekzistencë, përveç Allahut. Kjo, pasi të gjitha krijesat ia kanë nevojën të tjerëve."

Në fakt, kjo që ata thonë, ka hapur derën e shirkut muslimanëve, sepse ata mendojnë se teuhidi është njësimi i Allahut vetëm në *rububije*. Për ata, kush beson se Allahu është i Vetmi Krijues, bëhet monoteist. Kush beson se askush nuk ia ka nevojën askujt në ekzistencë përveç Tij, është monoteist për ata. Por një gjë e tillë është nga të pavërtetat më të mëdha, sepse edhe mushrikët (politeistët) kurejshë e pohonin teuhidin *rububije*, siç tregon Kurani: "Nëse ti (Muhamed) i pyet ata se kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe kush i ka nënshtruar (të rrotullohen) Diellin e Hënën, - me siguri që ata do të thonë "Allahu!"<sup>8</sup> Dhe në një ajet tjetër: "Nëse ti i pyet ata: "Kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën?" Ata, me siguri do të thonë: "Ato i ka krijuar i Plotfuqishmi dhe i Gjithëdijshmi."<sup>9</sup> Ose: "Thuaj: Kush ju ushqen nga qielli dhe Toka? Kush mundëson të dëgjuarit dhe të parit? Kush mund të nxjerrë të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Kush i drejton gjërat?" Ata do të thonë "Allahu". E ti (o Muhamed) thuaj: "Atëherë, përse nuk e keni frikë Atë?" Ky është Allahu, Zoti juaj i vërtetë. E çfarë ka pas së vërtetës, përveç humbjes? Atëherë, përse largoheni?"<sup>10</sup>

Kështu, mësojmë se mushrikët kurejshë nuk mohonin teuhidin *rububije* dhe kjo tregon të kundërtën e asaj që thonë mutekelimunët në lidhje me kuptimin e "la ilahe" se kallëzuesori i fshehur është "*meuxhudun*" (në ekzistencë), prandaj – sipas tyre - e gjitha shprehja domethënë: Nuk ekziston i adhuruar, përveç Allahut. Kjo nuk është e vërtetë, pasi ne shikojmë se të adhuruarit janë shumë. Allahu i Lartësuar na tregon çfarë thonin mohuesit: "A mos kërkon ai që të gjithë zotat t'i bëjë një Zot të Vetëm?"<sup>11</sup> Ajeti tregon se të adhuruarit janë të shumtë, ata ekzistojnë, ndaj dhe kallëzuesori i fshehur "*meuxhudun*" është gabim. Njihet në gjuhën arabe fakti se kallëzuesori i "la" (nuk), mohues i llojit, në shumë raste fshihet (nuk përmendet), madje edhe në tekstet e Librit dhe të Sunetit. Një gjë e tillë ndodh kur kallëzuesori "la" është i nënkuptueshëm, kur dëgjuesi e kupton qëllimin. Nëse qëllimi i kallëzuesorit është i kuptueshëm, atëherë ai hiqet, në mënyrë që fjalët të jenë më të përmbledhura, ashtu siç është thënia e të

<sup>8</sup> EL-ANKEBUT:61.

<sup>9</sup> EZ-ZUHRUF: 9.

<sup>10</sup> JUNUS: 31-32.

<sup>11</sup> SAD: 5.

Dërguarit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): "Nuk ka *"adua"* (infeksion), as *tijera* (besëtytni me një lloj zogu), as *hameh*<sup>12</sup> dhe as *sefer*<sup>13!</sup><sup>14</sup> Ku është kallëzuesori këtu?

Përgjigjja: Në të gjitha këto shprehje, kallëzuesori është fshirë, sepse ai nënkuptohet nga dëgjuesi. Pra, kallëzuesori i shprehjes "la ilahe" nënkuptohet, dhe nuk është e saktë se, ajo që nënkuptohet, është fjala "ekziston"; meqë ekzistojnë zota që adhurohen bashkë me Allahun.

Mendimi i saktë është se kallëzuesori i fshehur është fjala "me të drejtë" apo "të vërtetë", domethënë "Nuk ka zot me të drejtë" ose "Nuk ka të adhuruar me të drejtë, përveç Allahut".

Kuptimi i shehadetit është "Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut". Kjo tregon se ka edhe të tjerë që adhurohen krahas Allahut të Madhërishëm. Por, a është ky adhurim i drejtë, apo adhurim i kotë e i padrejtë? Përgjigjja është se ky adhurim është i kotë dhe i padrejtë. Këtë kupton një arabishtfolës sapo dëgjon fjalën "La ilahe il-Allah".

Kjo është arsyeja edhe që shejh Muhamed Ibn Abdul Uehabi për këtë ka thënë: "Ebu Xhehli ishte më i keqi i njerëzve dhe më i dituri për "La ilahe il-Allah"<sup>15</sup> Ebu Xhehli e kuptonte këtë fjalë, prandaj nuk pranonte ta shprehte. Nëse kuptimi i saj do të ishte "Nuk ka zot në ekzistencë", siç pretendojnë shumë dijetarë në këtë kohë, por edhe para saj, ata do ta shprehnin lehtësisht atë pa e ditur se çfarë kuptimi kishte, por ata e dinin se kuptimi i saj është: Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se adhurimi i të tjerëve përveç Tij është padrejtësi. A e pranonin ata këtë padrejtësi, tirani dhe mizori?!

<sup>12</sup> "*Hameh*" është një lloj zogu. Kur një person vritej në mënyrë të padrejtë, thonin se ky zog qëndron mbi varrin e tij duke nxjerrë një zë çjerrës, derisa të merret haku për të. Thonin gjithashtu se "*hameh*" është shenjë vdekjeje. (shënim i përkthyesit)

<sup>13</sup> "*Safer-i*" - thuhet se është fjala për muajin sefer (të kalendarit islam), se njerëzit në kohën paraislame e shihnin si ters këtë muaj, ndaj nuk martoheshin, nuk udhëtonin dhe as nuk bënin tregti në këtë muaj. Thuhet gjithashtu se *safer-i* është një sëmundje që zë barkun dhe që arabët pretendonin se ishte e transmetueshme (shënim i përkthyesit)

<sup>14</sup> Buhariu: 3707, Muslimi: 2220. Shiko: *Tefsir Hametu*, sifre dhe *gaul*. Shpjegimi i këtyre shprehjeve do të bëhet edhe më poshtë.

<sup>15</sup> Shiko: Kapitullin thënia e Lartësuarit: Vërtet, ti (Muhamed) nuk mund të udhëzosh kë të duash, por është Allahu Ai që udhëzon kë të dëshirojë. Ai i njuh më mirë ata që janë të udhëzuar. EL-KASAS: 56 , faqja:218.

Kështu, kuptimi i shprehjes "La ilahe il-Allah" është ai që ne përmendëm dhe shpjeguam më lart. Ajo përfshin mohimin dhe pohimin, ashtu siç do të sqarohet në ajetin e sures "Ez-Zuhruf", në thënien e të Madhërishmit:

“(Kujto) kur Ibrahim i tha të atit dhe popullit të tij: “Në të vërtetë, Unë i urrej dhe s’kam të bëj fare me ato që adhuroni ju në vend të Atij, që më ka krijuar dhe i Cili do të më udhëzojë në rrugën e drejtë”.<sup>16</sup>

Imami (Allahu e mëshiroftë!) thotë:

Allahu i Lartësuar thotë: “Vetë ata që idhujtarët u luten, kërkojnë t’i afrohen Zotit të tyre, madje edhe më të afërtit, duke shpresuar mëshirën e Tij dhe duke iu frikësuar dënimit të Tij.”<sup>17</sup>

Ky ajet është shpjegim i teuhidit. Kjo pasi ne mësuam se teuhidi është njësimi i Allahu në adhurim, i cili quhet "teuhidi uluhije". Ky ajet lavdëron adhuruesit e veçantë të Allahut, duke deklaruar se ata e njësojnë Allahun në adhurim. Kështu përshtatet ajeti kuranor me këtë kapitull. Allahu i Lartësuar i përshkruan ata: “Vetë ata që idhujtarët u luten...” Kuptimi i "jed'une" (luten) është: adhurojnë, për shkak se lutja është adhurim.

Lutja është dy llojesh, siç do të shpjegohet edhe më pas: lutje kërkese dhe lutje adhurimi. Këtu thënia e të Lartësuarit: “Vetë ata që idhujtarët u luten” domethënë: adhurojnë. Ndërkaq “*kërkojnë t’i afrohen*” domethënë që përmbushjen e nevojave të tyre ata e kërkojnë nga Allahu dhe afrohen tek Ai me vepra të mira: “Vetë ata që idhujtarët u luten, kërkojnë t’i afrohen Zotit të tyre” Domethënë, ata kërkojnë që nevojat e tyre t’ua plotësojë Zoti i tyre, i Cili është Krijuesi dhe ka mundësinë për t’iu përgjigjur.

Ndër çështjet e parashtruara nga Nafi Ibn el Erzek<sup>18</sup> për Ibn Abasin<sup>19</sup> ishte se çfarë kuptimi kishte fjala "*el-uesile*" në thënien e Allahut të Lartësuar në suren Maide: “O besimtarë! Kini frikë Allahun, përpquni që t’i afroheni Atij me vepra të mira dhe luftoni në rrugën e Tij për të shpëtuar!”<sup>20</sup> Ai iu përgjigj se kuptimi i saj ishte: “nevojë”. Ai e pyeti: “A e njohin arabët një gjë të tillë?” Ibn Abasi i tha: “Po.

<sup>16</sup> EZ- ZUHRUF: 26 – 27.

<sup>17</sup> EL-ISRA: 57.

<sup>18</sup> Është fjala për Nafi' ibn el-Ezrek Elhururi, nga të parët e havarixhëve; nga ai rrjedh fisi Ezarik. Shiko: Lisanul arab: 6/144.

<sup>19</sup> Këtë çështje e ka sjellë Sujuti në: *Ed-derr menthur*: 3/71, Tasti dhe Ibn Anbarij në: *Vakf dhe ibtidai*”.

EL- MAIDE: 35.

A nuk e ke dëgjuar vargun e poetit Intera<sup>21</sup> drejtuar një gruaje: *Burrat për ty kanë nevojë*<sup>22</sup>... Thënia e Interas "*el uesile*" domethënë: k anë nevojë t'u zgjidhësh një hall.

Pjesa argumentuese nga ajeti i sures Maide është thënia: "...kërkojnë t'i afrohen Zotit të tyre." Parafjala "*ila*" vjen para emrit "*el uesile*", që nënkupton kufizim.

Disa dijetarë mendojnë se, kur parafjala e rasës gjinore vjen para një emri, ajo shërben për specifikim. Cilado qoftë, aspekti argumentues i ajetit "*...luten, kërkohet t'i afrohen Zotit të tyre...*" është i qartë; ai tregon se nevojën e tyre ata ia parashtrajnë vetëm Allahut e askujt tjetër.

Ajeti vjen në kontekstin e teuhidit rububije, pasi është përmendur fjala "Rab-bihim" (Zotit të tyre) dhe nuk është përdorur, për shembull, "Allahut (Adhuresit) të tyre". Kjo, pasi përgjigjja e lutjes dhe realizimi i kërkesave janë njësi të "teuhidit rububije" dhe jo të "teuhidit uluhije". Rezultati i "teuhidit rububije" është përgjigjja e lutjes dhe plotësimi i kërkesës.

Nga kjo del se thënia e të Madhërishtit "*...kërkojnë t'i afrohen Zotit të tyre*" shpjegon teuhidin, sepse të gjitha nevojat i parashtrihen Allahut të Madhëruar. Edhe fjala: "jed'ûne" (luten) shpjegon teuhidin, pasi kuptimi i fjalës "jed'ûne" (luten) është: "adhurojnë". Ata (për të cilët bën fjalë ajeti) kërkojnë që nevojat e tyre t'ua plotësojë vetëm Allahu i Lartësuar dhe nuk adhurojnë asgjë tjetër përveç Allahut. Kur bëjnë kurban, e bëjnë vetëm për Allahun, me qëllim të plotësimit të nevojave vetëm prej Tij; kur falin namaz, falin vetëm për t'u afruar me Allahun; kur kërkojnë ndihmë, kërkojnë vetëm prej Allahut, me dëshirën e plotësimit të nevojave vetëm prej Tij, e kështu me radhë në të gjithë elementet e teuhidit të adhurimit.

Kështu, ajeti: "*...luten, kërkohet t'i afrohen Zotit të tyre*"<sup>23</sup> tregon qartazi se ky është teuhidi. Disa dijetarë kanë qenë të paqartë në lidhje me përmendjen e këtij ajeti në këtë kapitull dhe kanë ngritur pyetjen mbi lidhjen që ka ky ajet me këtë kapitull. Por, pas gjithë sa thashë, është e qartë lidhja e ajetit me kapitullin.

Thënia e Allahut të Lartësuar "*...Madje edhe më të afërtit, duke shpresuar mëshirën e Tij dhe duke iu frikësuar dënimit të Tij.*" Ajeti tregon për gjendjen e robërve të veçantë të Allahut, të cilët kanë edhe adhurimin, edhe frikën ndaj Tij. Ata shpresojnë në mëshirën e Allahut dhe i frikësohen dënimit të Tij. Ata i

<sup>21</sup> Ky është Entare ibn Shedad ibn Muavija Ijsij, nga më të spikaturit e poetëve dhe kalorës i njohur arab. Shiko: Tabekat feul shuara" i Ibn Selam: 1/52.

<sup>22</sup> Shiko: Librin e tij "Dijvan", faqe: 14.

<sup>23</sup> Sure ISRA: 57.

drejtohen vetëm Atij. Ata shprehin frikë, dashuri, lutje, dëshirë dhe shpresë vetëm nga Allahut i Lartësuar. Ky është edhe shpjegimi i teuhidit.

Shejhu (Allahu e mëshiroftë!) thotë:

Allahu i Lartësuari thotë në Kuran: “(Kujto) kur Ibrahim i tha të atit dhe popullit të tij: “Në të vërtetë, Unë i urrej dhe s’kam të bëj fare me ato që adhuroni ju në vend të Atij, që më ka krijuar dhe i Cili do të më udhëzojë në rrugën e drejtë” Ai e bëri këtë fjalë të përhershme te pasardhësit e tij, me qëllim që ata të kthehen vazhdimisht (tek Allahu).<sup>24</sup>

Argument në këtë ajet është thënia e të Madhëruarit: “Në të vërtetë, Unë i urrej dhe s’kam të bëj fare me ato që adhuroni ju në vend të Atij, që më ka krijuar” Aspekti argumentues lidhet me faktin se në këtë ajet përmendet distancimi nga njëra anë dhe pohimi në anën tjetër. Fjala është për distancimin nga ato që të tjerët adhurojnë. Disa dijetarë kanë thënë se Ibrahim (paqja e Allahut qoftë mbi të!) u distanca nga adhurimi i idhujve para se të distancohej nga adhuruesit e tyre, sepse, nëse dikush heq dorë nga e para, ka arritur në nivelin më të lartë të urrejtjes dhe mohimit të atyre adhurimeve. Ky shpjegim është bërë në suren Mumtehine.

Përshtatshmëria e ajetit me kapitullin qëndron në faktin se ajeti “Në të vërtetë, Unë i urrej dhe s’kam të bëj fare me ato që adhuroni ju në vend të Atij, që më ka krijuar” përmban mohim dhe pohim, të barasvlershëm me falën e teuhidit, madje janë teuhidi vetë.

Në këtë ajet shpjegohet dëshmia "La ilahe il-Allah", ndaj dhe i Lartësuari thotë më pas: “Ai e bëri këtë fjalë të përhershme te pasardhësit e tij”. Cila është kjo fjalë? Ajo është fjala "La ilahe il-Allah", siç e komentojnë këtë të parët tanë.<sup>25</sup>

Thënia e të Madhëruarit “Në të vërtetë, Unë i urrej dhe s’kam të bëj fare me ato që adhuroni ju,” përmban mohimin e asaj të cilën tashmë e dimë: "La ilahe" (nuk ka zot); kurse thënia "...që më ka krijuar" përmban pohim, të cilin e kuptojmë nga thënia:"Il-IAllah" (përveç Allahut).

Pra, në këtë ajet ndodhet shpjegimi i dëshmisë: “La ilahe il-Allah”, sepse shprehja "La il-lahe" nënkuptohet nga “Në të vërtetë, Unë i urrej dhe s’kam të bëj

<sup>24</sup> EZ- Zuhruf: 26 – 28.

<sup>25</sup> Shiko: Tefsir eth-Theuri, faqja: 270, Tefsir Taberiju: 25/63.



fare me ato që adhuron ju,"<sup>26</sup> ndërsa "il-Allah" nënkuptohet nga: "...që më ka krijuar".

Në këtë ajet të sures Zuhruf, Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) u shpjegon atyre domethënien e fjalës së teuhidit, duke u thënë: "Në të vërtetë, Unë i urrej dhe s'kam të bëj fare me ato që adhuron ju në vend të Atij, që më ka krijuar." "Berra'etu" (distancim) do të thotë: mohimi, shfaqja e armiqësisë dhe urrejtja e adhurimit të të tjerëve përveç Allahut. Ky distancim është i domosdoshëm. Askush nuk është musliman, derisa ky distancim të marrë jetë në zemrën e tij, pasi, nëse kjo nuk sendërtohet në zemër të dikujt, ai njeri nuk është njësuës. Distancim, në këtë rast, do të thotë të urresh, të mohosh dhe ta luftosh adhurimin e dikujt tjetër përveç Allahut, siç deklaroi Ibrahim (paqja e Allahut qoftë mbi të!) në këtë ajet: "Unë i urrej dhe s'kam të bëj fare me ato që adhuron ju."

Distancimi nga adhuruesit e idhujve është pjesë e rëndësishme e teuhidit, por jo bazë e tij. Kjo domethënë që, mosarmiqësimi me idhujtarët ka pozita të ndryshme; ka raste ku konsiderohet *kufër*, ka raste kur konsiderohet një lloj solidarizimi, që nuk arrin në gradën e *kufrit*.

Pastaj thuhet: "...përveç Atij, që më ka krijuar". Ky përjashtim është si ai në fjalën e teuhidit "La ilahe il-Allah". Disa dijetarë, në lidhje me ajetin "...përveç Atij që më ka krijuar" kanë thënë se është përmendur krijimi për të nxjerrë në pah se, Ai që meriton adhurim, është Ai që krijon, ndërsa, ai që nuk krijon, nuk meriton të adhurohet. Përshtatja e ajetit me kapitullin është e qartë e po kështu edhe pjesa argumentuese.

Allahu i Madhëruar thotë: "Në vend të Allahut, ata kanë zgjedhur për zota rabinët dhe murgjit e tyre."<sup>27</sup> "Erbab" është shumësi i "rab". Fjala "Erbab" këtu është përdorur me kuptimin e adhurimit, domethënë ata adhurojnë murgjit dhe rabinët e tyre "në vend të Allahut"<sup>28</sup> apo krahas Allahut. Kjo për arsye se iu binden atyre në ndalimin e gjërave të lejuara dhe në lejimin e gjërave të ndaluara. Bindja është pjesë e teuhidit, një degë e adhurimit. Nëse dikush i bindet tjetërkujt përveç Allahut në lejimin e të ndaluarave dhe ndalimin e të lejuarave, ai adhuron atë e jo Allahun. Ky ajet përmend një degë dhe element të teuhidit, që është bindja. Rreth kësaj do të flitet në një kapitull të veçantë, në dashtë Allahu. Aty do të sqarohen edhe disa koncepte të veçanta.

<sup>26</sup> EZ- Zuhruf: 26.

<sup>27</sup> ET-TEUBE: 31.

<sup>28</sup> ET-TEUBE: 31.

Shejhu thotë:

“Allahu i Lartësuar ka thënë: “E, megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë, (duke i konsideruar) si të barabartë me Atë dhe duke i dashur siç duhet Allahu. Por ata që besojnë, e duan shumë më tepër Allahun (sesa ç’i duan idhujtarët idhujt e tyre).”<sup>29</sup>

Allahu i Lartësuar tregon se mushrikët kanë marrë zota të tjerë si të barabartë me Allahun dhe u dedikojnë atyre adhurime të ndryshme. Allahu i përshkuan ata: “...duke i dashur siç duhet Allahu.” Në lidhje me këtë, komentuesit e parë dhe të mëvonshëm kanë dy mendime:

- Duke i dashur zotat e tyre siç duhet Allahu.
- Duke i dashur zotat e tyre siç duan muslimanët Allahun.

Shkronja "kef" (siç), në tekstin origjinal, ka kuptimin: “njëlloj, në mënyrë të barabartë”, siç është thënia e Allahut të Madhëruar: "Por, pas kësaj, zemrat tuaja u forcuan e u bënë si guri, madje edhe më të forta."<sup>30</sup> Këtu shkronja "kef" (si) është emër, kuptimi i të cilit është “i njëjtë, i barabartë”.

Kështu ajeti “duke i dashur siç duhet Allahu” domethënë se mushrikët e barazonin dashurinë ndaj zotave me dashurinë për Allahun. Ata e donin jashtë mase Allahun, por ata i donin gjithashtu jashtë mase edhe zotat e tyre. Kjo shenjë barazimi është *shirk* dhe është pikërisht kjo ajo që i bëri ata banorë të Zjarrit, siç thotë Allahu i Lartësuar, duke na treguar fjalët e banorëve të Zjarrit në suren Shuara: “Betohemi për Allahun, ne kemi qenë njëmend në humbje të qartë, kur ju kemi barazuar me Zotin e botëve.”<sup>31</sup>

Dihet se politeistët nuk i barazonin zotat me Zotin e botëve në krijim, në furnizim dhe në njësitë e tjera të teuhidit, por i barazonin në dashuri dhe në adhurim. Atëherë, kuptimi i ajetit “...duke i dashur siç duhet Allahu” është se ata i donin idhujt e tyre po aq sa donin Allahun. Ky shpjegim është më i saktë se tjetri, që thotë se ata i donin idhujt e tyre siç e duan besimtarët Allahun, ndërkohë që besimtarët e duan Allahun edhe më shumë.

Argumentimi me këtë ajet dhe përshtatshmëria e tij me kapitullin është e qartë se *shirku në dashuri* bie në kundërshtim me fjalën e teuhidit, madje e mohon teuhidin që në themel. Allahu thotë se ata i kanë marrë për "*endeda*" (zota)

<sup>29</sup> EL-EL-BEKARE:165.

<sup>30</sup> EL-EL-BEKARE: 74.

<sup>31</sup> ESH-SHUARÂ: 97- 98.

krahas Allahut dhe i duan siç e duan Allahun, pra kështu i përshkroi ata. Nuk ka dyshim se dashuria është një lloj i adhurimit. Dashuria është promotore. Është ajo që nxit reagime dhe vepra. Sjellja e ajetit këtu lidhet me faktin se dashuria është një lloj adhurimi, prandaj, për sa kohë që politeistët nuk e njësojnë Allahun në këtë adhurim, konsiderohen se adhurojnë zota të tjerë krahas Allahut. Ky është thelbi i teuhdit dhe kuptimi i dëshmisë "La ilahe il-Allah".

Pastaj Shejhu (Allahu e mëshiroftë!) thotë:

Në *Sahih*, Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka deklaruar se:

"Kush thotë "*La ilahe il-Allah*" dhe mohon atë që adhurohet përveç Allahut, i mbrohet pasuria edhe gjaku i tij, kurse llogaria e tij është tek Allahu i Madhëruar."

Edhe ky hadith shpjegon kuptimin e teuhidit dhe të shehadetit "La ilahe il-Allah". Ka një ndryshim midis thënies vetëm "La ilahe il-Allah" dhe thënies "teuhidi dhe shehadeti", sepse, kur themi "teuhidi dhe shehadeti", kemi shprehur diçka që qëndron një shkallë më lart.

Ky hadith ka edhe një kushtëzim shtesë mbi shprehjen e thjesht vetëm të dëshmisë, që qëndron në fjalën e të Dërguarit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): "La ilahe il-Allah dhe mohon atë që adhurohet përveç Allahut". "*Uau*" (dhe) është pjesëz lidhore, që domethënë se gjymtyrët para dhe pas lidhëzës janë të njëjta, që do të thotë se çfarë përmendet pas kësaj pjesëze është e ndryshme nga ajo para saj, pasi në origjinë roli i një lidhëze është të bëjë lidhjen mes dy gjërave të ndryshme. Kështu, thënia "...dhe mohon atë që adhurohet përveç Allahut" është një shtesë nga shqiptimi thjesht i shehadetit. Atëherë, kuptimi është se ai ka thënë "La ilahe il-Allah" dhe bashkë me të: "...dhe mohon atë që adhurohet përveç Allahut", domethënë që është distancuar nga çdo gjë që adhurohet përveç Allahut. Ky është njëri mendim.

Mendimi i dytë është se "uau" (dhe) këtu, edhe pse është pjesëz lidhore, nuk nënkupton plotësisht diçka ndryshe, por është në kontekstin e lidhore shpjeguese dhe se, ajo që vjen pas saj, është pjesa e asaj para, siç është thënia e Allahut të Lartësuar: "Kush është armik i Allahut, i engjëjve të Tij, i të Dërguarve të Tij, i Xhebrailit dhe Mikailit."<sup>32</sup> Xhebraili dhe Mikaili janë engjëj gjithashtu, por ata vijnë pas lidhëzës për t'i përmendur në mënyrë të veçantë dhe për të nxjerrë na pah rëndësinë e tyre. Kjo pasi hebrenjtë thoshin fjalë qortuese për Xhibrilin dhe Mikailin.

<sup>32</sup> EL-EL-BEKARE: 98.

Qëllimi është se lidhëza "dhe" bashkon një pjesë të shkëputur nga një e tërë që përmendet para saj ose është lidhëse shpjeguese. Kjo shpjegon dëshminë: "La ilahe il-Allah".

Kështu, në bazë të mendimit të dytë, shprehja përfshin mohimin e gjithçkaje që adhurohet përveç Allahut, sikurse u tha më sipër, në komentin e ajeteve të sures Zuhruf: "Kur Ibrahim i tha të atit dhe popullit të tij: "Unë i urrej dhe s'kam të bëj fare me ato që adhuroni ju në vend të Atij, që më ka krijuar.", se distancimi nënkupton urrejtje, mohim, armiqësi. Mohimi lidhet me adhurimet që bëheshin krahas Allahut. Ky është shpjegimi i qartë i fjalës së teuhidit. Mendimi i dytë është më i saktë dhe më i përshtatshmi me kontekstin e sjellë nga Shejhu (Allahu e mëshiroftë!), madje është ai që përputhet me argumentet e sjella më herët.

"...i mbrohet pasuria edhe gjaku i tij, kurse llogaria e tij është tek Allahu i Lartësuar." Arsyeya është se, me këtë shprehje, njeriu bëhet musliman. Kush thotë "La ilahe il-Allah dhe mohon me përçmim gjithçka që adhurohet krahas me Allahun, bëhet musliman, dhe gjaku i muslimanit nuk lejohet të derdhet, vetëm se në një nga tre rastet e përcaktuara me ligj.<sup>33</sup> Gjithashtu, nuk lejohet që atij t'i merret pasuria, vetëm në rastin ku një gjë e tillë është e ligjshme, prandaj këtu thotë: "...i mbrohet pasuria edhe gjaku i tij."

Kështu, në këtë kapitull, nëpërmjet ajeteve dhe haditheve, del në përfundimin se shpjegimi i teuhidit dhe i dëshmisë "La ilahe il-Allah" kërkon nga muslimani përkujdesje të theksuar, meditim, shqyrtim dhe qetësi, derisa të arrijë ta kuptojë në mënyrë të argumentuar.

Më pas, Shejhu (Allahu e mëshiroftë!) thotë: "Shpjegimi i këtij kapitulli do ta bëjnë edhe kapitujt që do të vijojnë."

Në fakt, i gjithë libri shpjegon teuhidin, dëshminë "La ilahe il-Allah", të kundërtën e teuhidit (kufirin), çfarë e bie në kundërshtim që në themel me teuhidin dhe çfarë bie në kundërshtim me teuhidin e plotë. Po ashtu, ai qartëson shirkun e madh, të vogël, të fshehtë dhe shirkun me fjalë. Ai qartëson edhe disa gjëra të domosdoshme të teuhidit *uluhije*. Ai kërkon të pohohet se Allahut i Lartësuar ka emrat dhe cilësitë absolute dhe shpjegon se teuhidi i adhurimit është i lidhur me teuhidin rububije.

<sup>33</sup> Buhariu 6878 dhe Muslimi: 1676, sjellin hadithin nga Abdullah ibn Mesudi, se i Dërguari ka thënë: "Nuk lejohet të derdhet gjaku i muslimanit, që dëshmon se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Tij, përveçse në një nga tri rastet: i martuari që bën imoralitet, vrasësi, dhe ai që tradhton fenë, përçarësi i xhematit."